



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
UNIVERSITETI I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 234/prot
15

Tiranë më 26 . 7 .2022

VENDIM

Nr. 27 datë 20 . 07 .2022

**“PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË AUDITIMIT
REALIZUAR PRANË FAKULTETIT TË HISTORI FILOLOGJISË TË
UNIVERSITETIT TË TIRANËS “**

Në mbështetje të neneve 3 pika 3/c, 47, 49 e në vijim të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 8, 14, e në vijim të Ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në Sektorin Publik”, neni 12 “Përgjegjësia e titullarit të njësisë publike”, bazuar në planin vjetor 2022, për Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm të UT, miratuar me Vendimin nr.41 datë 25.10.2021, të Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

7. Miratimin e Raportit Përfundimtar të auditimit me objekt “*Auditim i përputhshmërisë dhe financiar*” së aktivitetit të Fakultetit të Histori Filologjisë të Universitetit të Tiranës, për periudhën 01.01.2019 deri më 31.12.2021, realizuar në zbatim të programit të auditimit nr.prot. 234/1, datë 07.02.2022 “Për angazhimin e auditimit për Fakultetin e Histori Filologjisë të Universitetit të Tiranës”,
8. Ky Raport Përfundimtar i përcillet zyrtarisht Fakultetit të Histori Filologjisë të Universitetit të Tiranës, së bashku me plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

